

Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

TJETRI

**dhe raportet me të nga
perspektiva kur'anore
dhe pejgamberike**



Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

TJETRI

dhe raportet me të nga perspektiva kur'anore dhe pejgamberike

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

TJETRI

- dhe raportet me të nga perspektiva kur'anore dhe pejgamberike -

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmimin e kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:

Sedat ISLAMI

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Titulli në origjinal:

Dr. Hajruddin Huxheh, *Nahve menhexhin kur'anijjin ve nebevijjin fi't teamuli mea'l ahar*, kumtese shkencore e përgatitur për “Trajnim për imamët dhe predikuesit islamë me vlerat e dialogut dhe të moderacionit”, Tiranë, 5-8 nëntor 2009.

Dr. Hajredin HOXHA

TJETRI

- dhe raportet me të nga perspektiva kur'anore dhe pejgamberike

بسم الله الرحمن الرحيم

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Përmbajtja:

Hyrje

Kush është “tjetri”?

1. Respektimi i qenies njerëzore
2. Urat e besimit dhe bashkëpunimit
3. Përvetësimi i tjetrit
4. Maturia në nxjerrjen e vendimeve
5. Përfitimi nga tjetri
6. Përmbushja e premtimeve dhe besnikëria
7. Falja dhe toleranca
8. Qëndrimi ynë ndaj çifutëve dhe të krishterëve

Propozim

Përfundim

Hyrje

Falënderuar qoftë Allahu, Krijuesi i qiejve dhe tokës! Lëvdatat qofshin për të Dërguarin e Tij të fundit, Muhammedin, familjen, shokët dhe të gjithë ata që ndjekin sinjerisht rrugën e tij!

Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë ka thënë:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا

Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun.” el-Ahzab, 21.

قُلْ إِن كُنتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ

Thuaj: "Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t'ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë.” Ali Imran, 31.

Pejgamberi ynë, Muhammedi (alejhi's selam), ishte prijës dhe shëmbëlltyrë. Allahu e dërgoi atë që të jetë i tillë për t'i udhëzuar njerëzit. Ai e dërgoi atë mëshirë për mbarë botët. E ne kemi shumë nevojë për udhëzimin, modelin dhe praktikën e tij, për t'i zgjidhur problemet tona shoqërore e fetare.

Kam bindjen se e ardhmja e njerëzimit është e lidhur ngushtë me dy faktorë:

→ Raportet e njeriut me Krijuesin, dhe

→ Raportet e njeriut me njeriun

Modelin më të përkryer të mundshëm, për të dy këto lloje raportesh (lidhjesh), e ka dhënë Pejgamberi ynë (alejhi's selam). Në aspektin fetar, pra atë të lidhjeve me Zotin, ai ishte në shkallën më të lartë të besimit, sinqeritetit, devotshmërisë dhe vetëpërmbytjes ndaj ndalesave të Tij. Ndërsa në sferën e marrëdhënieve me njerëzit, shëmbëlltyra e tij mbetet legjendë e pashuar. Biografia e tij është fakti dhe dëshmia më e mirë për këtë. Ai merrej shembull për raportet e shkëlqyera me të tjerët, për mëshirën e tij ndaj të dobëtëve, për bamirësinë e tij ndaj të huajve, për ndihmën e tij ndaj të varfërve, për butësinë e tij ndaj injorantëve, muslimanë apo të tjerë qofshin ata.

Bazuar në këtë dhe atë që thamë më parë, muslimanit nuk i mbetet tjetër veçse ta përvetësojë këtë moral dhe këtë edukatë, në mënyrë që sjelljet dhe veprimet e tij të kenë korrespondencë të sinqertë me kredon islame dhe moralin (edukatën) e tij.

Për ta kuptuar thelbësisht këtë problematikë bashkëkohore, e cila zë vend të theksuar tek duatët (thirrësit) dhe mendimtarët, ne gjithsesi se

do t'iu kthehemi disa haditheve peygamberike dhe sires¹ së peygamberit Muhammed (alejhi's selam).

Kush është “tjetri”?

Kohëve të fundit, në dialogët dhe shkrimet e autorëve dhe mendimtarëve të ndryshëm, na ka rënë shpesh ta dëgjojmë këtë fjalë. Por cilat janë shkaqet e përhapjes së saj dhe cili ishte qëndrimi i peygamberit Muhammed (alejhi's selam) ndaj të *tjerëve*?

“**Tjetri**”, siç sqarojnë disa ulema, është çdonjëri prej nesh në raport me tjetrin; grua ja është *tjetri*, babai është *tjetri*, djali është *tjetri*, shoku është *tjetri*, armiku është *tjetri*, kundërshtari në lojë është *tjetri*, muslimani është *tjetri*, çifuti është *tjetri*, i krishteri është *tjetri* etj.

Por, si terminologji, botëkuptimi i kësaj fjale më shumë ka të bëjë me perëndimin, gjegjësisht, jomuslimanët, çifutët dhe të krishterët, dhe kjo për shkak të ngërçit që kanë pësuar raportet politike, diplomatike dhe fetare ndërmjet tyre dhe për shkak të së kaluarës së tyre të përgjakshme.

Ndërsa sa i përket qëndrimit të peygamberit Muhammed (alejhi's selam), atë më së miri mund ta kuptojmë nga shkoqitja e disa inserteve nga jeta e tij.

¹ Biografisë.

1. Respektimi i qenies njerëzore

Njerëzit – na mëson peygamberi Muhammed (alejhi's selam) – mund të kenë gjuhë, ngjyrë dhe fe të ndryshme, por megjithëkëtë kanë diç të përbashkët, që mund t'i bashkojë ata të gjithë. Nëse raportet ndërmjet tyre ndërtohen mbi bazën e respektit të ndërsjellë atëherë ky ideal mund të jetësohet. Allahu ka thënë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ

O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” el-Huxhurat, 13.

Allahu i Madhëruar i nderoi bijtë e Ademit (njerëzit) duke i veçuar ata me intelekt dhe mundësi të ndryshme, ndër të cilat edhe nënshtrimin e hapësirës (kozmosit). Këtë dhunti ia dha njeriut, pa marrë parasysh se çfarë përkatësie fetare ka. Edhe në traditën e peygamberit Muhammed (alejhi's selam) mund të hasim një praktikë të tillë. Imam Buhariu ka regjistruar në Sahihun e tij rastin e kalimit të kufomës së një çifuti, për të cilën Peygamberi (alejhi's selam) qe ngritur në këmbë me arsyetimin:

أليست نفسا“

A nuk është qenie kjo?!”

Ky rast, nga ky hadith i mrekullueshëm, është vetëm një prej mijëra dëshmive të tolerancës islame dhe filozofisë së tij karshi qenies njerëzore.

2. Urat e besimit dhe bashkëpunimit

Allahu i Madhëruar ka thënë:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَتُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَلَوْ آمَنَ أَهْلُ الْكِتَابِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ مِّنْهُمْ الْمُؤْمِنُونَ وَأَكْثَرُهُمُ الْفَاسِقُونَ

Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni Allahun. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit.” Ali Imran, 110.

وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ اَنْ صَدُّوْكُمْ عَنِ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ اَنْ تَعْتَدُوْا وَتَعَاوَنُوْا عَلٰى الْبِرِّ وَالتَّقْوٰى وَلَا تَعَاوَنُوْا عَلٰى الْاِثْمِ وَالْعُدْوَانِ وَاتَّقُوا اللَّهَ اِنَّ اللَّهَ شَدِيْدُ الْعِقَابِ

...Urrejtja ndaj një populli, që iu pat penguar nga xhamia e shenjtë, të mos ju shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre. Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi. Kini dro dënimit të All-llahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë.”el-Maide, 2.

Pejgamberi (alejhi’s selam) ishte shumë i zellshëm për ndërtimin e lidhjeve të fuqishme me *tjetrin* dhe gjenerimin e ndjenjave pozitive ndërmjet tyre. Nëse shfletojmë siren e tij do të arrijmë shumë lehtë tek kjo e vërtetë. Kur migroi nga Meka në Medinë, ai mori si udhërrëfyes Abdullah b. Urejkit Lejthiun, i cili në fakt ishte idhujtar. Mund të paramendoni se për çfarë udhëtimi të rrezikshëm bëhej fjalë dhe çfarë shpërblimi marramendës (prej 100 devesh) ishte ofruar për kapjen e Pejgamberit (alejhi’s selam)! Por ishte metodologjia pejgamberike në të qenit i hapur ndaj *tjetrit* dhe krijimin e një lloj bese reciproke që e shtyri t’i përballojë këto rreziqe.

Rrëfimi tjetër është edhe më i çuditshëm se ky. Kurejshët, me gjithë faktin se e persekutonin Muhammedin (alejhi’s selam) dhe ushtronin trysni të vazhdueshme ndaj tij, kishin besim të madh tek ai, saqë gjërat me vlerë ia besonin atij. Pejgamberi (alejhi’s selam) i pranonte ato dhe i ruante me besnikëri. Kjo natyrisht për shkak të nevojës së krijimit të atmosferës së besimit dhe sinqeritetit, mënyrë kjo për përfitimin e zemrave të pjesëtarëve të rinj të misionit islam.

Dëshmi tjetër që provon këtë moral pejgamberik është edhe hadithi, të cilin e transmeton Imam Buhariu nga sahabiu i nderuar Enes b. Maliku, që thotë:

كَانَ غُلَامٌ يَهُودِيٌّ يَخْدُمُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَمَرِضَ فَأَتَاهُ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ “يَعُودُهُ فَقَعَدَ عِنْدَ رَأْسِهِ فَقَالَ لَهُ أَسْلِمَ فَنَظَرَ إِلَى أَبِيهِ وَهُوَ عِنْدَهُ فَقَالَ لَهُ أَطِيعْ أَبَا الْقَاسِمِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَأَسْلَمَ فَخَرَجَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَهُوَ يَقُولُ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْقَذَهُ مِنَ النَّارِ

Pejgamberi (alejhi's selam) kishte si shërbëtor një djalosh të ri çifut, i cili u sëmur. Pejgamberi (alejhi's selam) i shkoi për vizitë në shtëpi. Iu ul afër kokës dhe i tha: Pranoje Islamin! Djaloshi shikoi babanë, ndërsa ai i tha: Respektoje Ebu'l Kasimin!² Djaloshi e pranoi Islamin, ndërsa Pejgamberi (alejhi's selam) doli prej shtëpisë së tij duke thënë: Falënderimi i takon Allahut që e shpëtoi prej zjarrit!”

Sot, disa muslimanë mund ta shohim me skepticizëm këtë ngjarje, por çështja atëkohë ishte kësisoj. Shoqëria islame ishte e hapur dhe kjo ka bërë që ithtarët e feve të tjera të njihen në masë të madhe me Islamin, misionin dhe moralin e tij.

Raportet e ftohta dhe ndarjet që mund t'i evidentojmë sot ndërmjet vetë muslimanëve, por edhe ndërmjet tyre dhe ithtarëve të feve të tjera, nuk janë produkt i këshillave dhe edukatës fetare aq sa janë produkt i ndjenjave psikike dhe zakoneve e traditave shoqërore të ndërtuara mbi

² Kështu ishte nofka e Pejgamberit (alejhi's selam).

bazën e frikës dhe dyshimit. Islami na e ka lejuar vizitën e *dhimmiut* (jomuslimanit që jeton në shtetin islam paqësisht), këshillimin dhe bamirësinë ndaj tij, si dhe e ka ndaluar padrejtësinë ndaj tyre. Ka dallim të madh ndërmjet jomuslimanit që jeton paqësisht në mesin e muslimanëve dhe jomuslimanit që i lufton dhe iu shpall armiqësi muslimanëve.

Dëshmi tjetër që fakton raportet e Muhammedit (alejhi's selam) me jomuslimanët është edhe tregtia me ta. Imam Buhariu sjell rrëfimin e çifutëve të Hajberit, të cilëve Pejgamberi (alejhi's selam) ua pati dhënë tokat dhe arat për punë me fitimin përgjysmë.

Po kështu është vërtetuar se Pejgamberi (alejhi's selam) e pati lënë peng parzmoren e tij tek një çifut për të marrë 30 saë elb. Pejgamberi (alejhi's sela) ia pati dhënë Omeri një rrobe ndërsa ky i fundit ia pati dërguarit vëllait të vet në Mekë që atëbotë ende nuk ishte musliman.

Kjo mirësi reciproke dhe ky respekt i ndërsjellë bart në vete disa nga kuptimet e shtetësisë apo jetesës në një tokë të përbashkët. Këto sjellje dhe veprime të Pejgamberit, alejhi's selam përputhen plotësisht me fjalën e Allahut të Madhëruar:

“لَا يَنْهَاكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُقَاتِلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُمْ مِّنْ دِيَارِكُمْ أَن تَبَرُّوهُمْ وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ

الْمُقْسِطِينَ

All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë.” el-Mumtehineh, 8.

Kjo mirësi – sipas asaj që kanë sqaruar disa dijetarë – nënkupton butësinë ndaj të dobëtëve ndërmjet tyre, përmbushjen e nevojave të fukarenjve të tyre, ushqimin e të uriturve të tyre, veshjen e të zhveshurve të tyre dhe foljen me butësi e jo me vrazhdësi për t'i frikësuar e poshtëruar

3. Përvetësimi i tjetrit

Ndodh që për x shkaqe të ketë mospajtime ndërmjet palëve, por Pejgamberi (alejhi's selam) na ka mësuar mënyrën e zgjidhjes së tyre, duke u marrë me thelbin e problematikave e jo me formalitetet e tyre. Allahu thotë:

وَإِنْ جَنَحُوا لِلسَّلَامِ فَاجْنَحْ لَهَا وَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek All-llahu. Ai është që dëgjon dhe di.” el-Enfale, 61.

Ai që mediton për qëndrimet e Pejgamberit (alejhi's selam) ndaj jomuslimanëve dhe hipokritëve do t'i vërejë shumë qartë këto botëkuptime. Sa për shembull, do të ktheheshim tek Marrëveshja e

Hudejbisë, respektivisht tek kundërshtimi i disa frazave të saj nga përfaqësuesi i palës tjetër, Suhejl b. Amri. Kur Ali b. Ebi Talibi shkroi: *“Bismil-lahi’rr Rrahmani’rr Rrahim”*, Suhejli kundërshtoi: -Ne nuk e dimë se kush është Rrahmani (andaj mos e shkruaj, por) shkruaje Bismike Allahumme! Pejgamberi (alejhi’s selam) e urdhëroi Aliun që ta bënte këtë. Pastaj Pejgamberi (alejhi’s selam) vazhdoi t’i diktonte Aliut tekstin e Marrëveshjes: *“Kjo është Marrëveshje e lidhur ndërmjet Muhammedit, të Dërguarit të Allahut”*, por Suhejli ndërhyri prapë duke i thënë: -Sikur të besonim se je i tillë (i Dërguar i Zotit) nuk do të pengonim nga vizita e Qabesë e as që do të luftonim, por shkruaje *“...Muhammedit, të birit të Abdullahut.”* Pejgamberi (alejhi’s selam) tha: *‘Unë, pasha Allahun, jam i Dërguar i Allahut, edhe nëse më përgënjeshtroi’*, ndërsa Aliun e urdhëroi ta shkruante *“...Muhammedit, të birit të Abdullahut”* dhe ta fshinte tekstin ku figuronte *“i Dërguari i Allahut”*. Aliu refuzoi ta bënte këtë, kështu që vetë Pejgamberi (alejhi’s selam) e fshiu atë me dorën e tij.

Kjo ndodhi patjetër se paraqet një sërë mësimesh për muslimanët, e në veçanti për thirrësit (hoxhallarët dhe të tjerët), për nevojën e gjetjes së mundësive për të qenë tolerantë në lidhje me ata që na kundërshtojnë, duke mos u ndalur shumë në gjëra sekondare, në mënyrë që fokusimi ynë tek bazamentet, tek thelbësoret, të mos zbehet kurrë. Pejgamberi (alejhi’s selam) ishte i bindur plotësisht se Allahu do ta ndihmonte dhe se ai gjithsesi se do të hynte në Mekë. Mu për këtë, ai nuk u mor shumë me disa formalitete, të cilat ndoshta në një shikim sipërfaqësor mund të

duken si të rëndësishme por gjatë hulumtimit dhe verifikimit dalin se nuk janë të tilla, por lëshoi pe për to. *Allahu e di më së miri!*

4. Maturia në nxjerrjen e vendimeve

Ngutja është pjesë e pandarë e personalitetit njerëzor. Fatkeqësisht, kjo cilësi siç duket është bërë dukuri në vendet e Ballkanit, ngase jo rrallë të bie të shohësh njerëz tek e gjykojnë tjetrin me humbje (dalalet), gabim, fisk, bidat, e madje edhe me kufër, dhe nëse ne nuk “ngutemi” që ta vëmë gjendjen nën kontroll, nëse nuk organizojmë seminare dhe konferenca të tilla siç është kjo për t’i kthyer njerëzit, imamët, thirrësi, studentët tek burimorja kur’anore, tek mesatarja në të cilën na fton Kur’ani, nëse nuk i pajisim me kulturë islame, atëherë nuk do të duhej të habiteshim nëse na vjen ndonjë dënim prej Zotit.

Pejgamberi (alejhi’s selam) e ka rekomanduar ummetin e tij që të mos nxitojë në krijimin e paragjykimeve dhe supozimeve përkitazi me të tjerët, në mënyrë të veçantë për ithtarët e librit, çifutët dhe të krishterët, dhe siç thotë:

ما حدثكم أهل الكتاب فلا تصدقوهم و لا تكذبوهم و قولوا : آمنا بالله و كتبه و رسله

Atë që ua thonë ithtarët e librit mos e merrni për të vërtetë, por as mos e përgënjeshtroini. Më mirë thoni: Besuam në Allahun, librat dhe të

Dërguarit e Tij...”³, ngase tek ata gjendet një pjesë e trashëgimisë së pejgamberëve.

5. Përfitimi nga tjetri

Njerëzit janë të ndryshëm dhe secili prej tyre mund të ketë diç që nuk e ka tjetri. Ndaj, në këtë kontekst, ky *tjetri* mund të ketë diç, njohuri a përvojë qoftë, që neve do të na ndihmonte në zgjidhjen e problemeve tona. Madje në tekstet fetare është potencuar se *urtësia është gjë e humbur të cilën besimtari duhet ta marrë kudo që ta gjejë*, gjë për të cilën ka aluduar edhe mufessiri bashkëkohor, Muhammed Emin Shenkiti, në Tefsirin e tij ‘Advau’l Bejan’. Në fakt, ai qëndrimet e besimtarit karshi kulturave të tjera i sheh të përmbledhura në këto katër pika:

- 1) Braktisja totale e kulturës dhe civilizimit perëndimor, duke përfshirë këtu edhe gjërat e dobishme;
- 2) Përvetësimi total i kësaj kulture, duke përfshirë këtu edhe aspektet negative;
- 3) Përvetësimi i aspekteve negative dhe anashkalimi i atyre pozitive;
- 4) Përvetësimi i aspekteve pozitive dhe braktisja e të tjerave.

³ Hadithin e transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij, ndërsa Albani në Sahihu ve Daifu Suneni Ebi Davud, e ka cilësuar të dobët (shën. i përkth.).

Më pas, hoxha i nderuar, vazhdon e thotë: *“Qëndrimi më i natyrshëm për Islamin dhe muslimanët karshi kësaj kulture do të ishte përvetësimi i aspekteve materiale (teknologjisë) dhe braktisja e arrogancës dhe kryeneçësisë së tyre ndaj Krijuesit të kozmosit, për të fituar kështu këtë botë dhe ahiretin. Por është për të ardhur keq se çështja në fakt ka devijuar; njerëzit përvetësojnë degjenerimin moral, zhveshjen nga feja dhe distancimin nga Krijuesi, duke rrezikuar shumë kështu humbjen e të dyjave: edhe të kësaj bote, edhe ahiretit.”*⁴

Një mendim të tillë, para tij, e ka ndarë edhe Shejhu’l Islam Ibni Tejmije, i cili në Fetava konsideron se: *“...nëse çështja nuk ka të bëjë me fenë por me gjëra të tjera, si mjekësia apo thjesht llogaritje (matematike), atëherë kjo është e lejuar. Mësimi i shkencës së mjekësisë nga një jomusliman është sikur të marrësh për udhërrëfyes një jomusliman apo të kërkohesh kurim prej tij. Madje kjo është edhe më e mirë, ngase ata nuk i kanë shkruar librat e tyre për llogari të muslimanëve që të ketë pas mundësi tradhtie në to; nuk ka nevojë për askënd prej tyre për tradhti: kjo është vetëm përfitim nga të arriturat e tyre, si përfitimi nga rrobat, shtëpitë, arat dhe armët e tyre, e kështu me radhë...”*⁵

Një gjë të këtillë e dëshmon edhe hadithi, të cilin e shënon Imam Muslimi:

⁴ Shih: Tefsiru Aduai’l Bejan, f. 826.

⁵ Mexhmuu’l Fetava, pj.3, f. 114-115.

لَقَدْ هَمَمْتُ أَنْ أَنْهَى عَنِ الْغِيلَةِ حَتَّى ذَكَرْتُ أَنَّ الرُّومَ وَفَارِسَ يَصْنَعُونَ ذَلِكَ فَلَا يَضُرُّ أَوْلَادَهُمْ

Pata menduar t'ua ndaloj gilen⁶ por përkujtova romakët dhe persët, të cilët e bëjnë një gjë të tillë dhe kjo nuk i dëmton aspak fëmijët e tyre.”

Armiqësia nuk mund të jetë aq e fortë saqë të na pengojë nga përfitimi prej përvojave të të tjerëve. Pejgamberi (alejhi's selam) përfitoi nga përvojat e persëve dhe romakëve për problematikën e theksuar më lart. Ngjashëm me të vepruan edhe halifët muslimanë. Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, përvetësoi Sistemin e Divanit dhe atë të Regjistrave Administrativë dhe Financiarë për Arkën Shtetërore të muslimanëve, sisteme këto të huaja për arabët.

⁶ Gile është marrëdhënia me gruan gjatë kohës që ajo ka fëmijën në gji apo ta lërë atë shtatzënë ndërkohë që ajo e ka fëmijën në gji.

6. Përbushja e premtimeve dhe besnikëria

Ky është një imazh tjetër i moralit të Pejgamberit (alejhi's selam) me të tjerët, kundërshtarë e armiq qofshin ata. Allahu ka thënë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَوْفُوا

O ju që besuat! Zbatoni premtimet...” el-Maide, 1.

إِلَّا الَّذِينَ عَاهَدْتُمْ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ثُمَّ لَمْ يَنْقُصُوكُمْ شَيْئًا وَلَمْ يُظَاهِرُوا عَلَيْكُمْ أَحَدًا فَأَتِمُّوا إِلَيْهِمْ عَهْدَهُمْ إِلَىٰ مُدَّتِهِمْ إِنَّ

اللَّهُ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ

Pos atyre idhujtarëve me të cilët keni lidhur marrëveshje, e të cilët nuk ju kanë shmangur asgjë dhe nuk e kanë ndihmuar askënd kundër jush, pra, edhe ju përbushni marrëveshjen e tyre deri në afatin e caktuar. S'ka dyshim se All-llahu i do të devotshmit.” et-Teube, 4.

فَمَا اسْتَقَامُوا لَكُمْ فَاسْتَقِيمُوا لَهُمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ

...e derisa ata i përmbahen (marrëveshjes) përmbahuni edhe ju. All-llahu i do ata që ruajnë besën.” et-Teube, 7.

Imam Muslimi, në Sahihun e tij, sjell tregimin e Hudhejfe b. Jemanit, i cili rrëfen: *Asgjë nuk më bëri të mos marrë pjesë në Betejën e Bedrit përveç se unë dhe Ebu Suhajli dolëm dhe u takuam me idhujtarët kurejshë, të cilët na thanë: -Ju qenkeni drejtuar tek Muhammedi? -Jo, ne duam të shkojmë vetëm në Medinë – iu përgjigjëm. Ata morën besën*

prej nesh se nuk do të luftonim përkrah Muhammedit (alejhi's selam) kundër tyre. Ne shkuam në Medinë dhe i rrëfyem të dërguarit të Allahut për rastin. “Shkoni (keni leje për mospjesëmarrje) ngase ne e përmbushim besën e tyre, kurse Allahun e lusim për ndihmë kundër tyre...”

Rast i ngjashëm është edhe ai në Marrëveshjen e Hudejbisë, ku një prej pikave të marrëveshjes ishte edhe kjo: “Kush shkon prej kurejshëve tek Muhammedi duhet kthyer prapë te kurejshët, ndërsa kush shkon tek kurejshët prej muslimanëve nuk obligohet kthimi i tij tek muslimanët.”

7. Falja dhe toleranca

Allahu i Madhëruar thotë:

خُذِ الْعَفْوَ وَأْمُرْ بِالْعُرْفِ وَأَعْرِضْ عَنِ الْجَاهِلِينَ

Ti (Muhammed) merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe hiq prej të padijshmëve.” el-A’rafe, 199.

فِيمَا رَحِمَهُ مِنَ اللَّهِ لَئِنْ هُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانْفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ

فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ

Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falua atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten.” Ali Imran, 159.

Këtë e dëshmon edhe vizita e Pejgamberit (alejhi’s selam) në Taif dhe pritja shumë përbuzëse që iu bë, ku madje ai edhe u torturua nga fëmijët dhe mendjelehtit e tyre. Kur Xhibrili zbriti bashkë me Melekun e Kodrave dhe i dha mundësinë Pejgamberit (alejhi’s selam) që të urdhëronte e ata (populli i Taifit) të shkatërroheshin, ai nuk e zgjodhi atë. Përkundrazi, u lut dhe shpresoi që prej tyre të dalin gjenerata që do ta adhuronin Allahun dhe nuk do t’i përshkruanin shok në asgjë.

Kështu ishte puna edhe me çlirimin e Mekës, ku u demonstrua ky moral hyjnor me të cilën u edukua Muhammedi (alejhi's selam). Pastaj, edhe hadithi i Enesit, ku sqarohet se *“Pejgamberi (alejhi's selam) nuk i ka rënë kurrë me shuplakë askujt, asnjë gruaje dhe asnjë shërbëtori, përveçse kur ka luftuar në rrugën e Allahut. Nuk ka ndodhur kurrë që ai të hakmerret kur është ofenduar prej dikujt, përveçse atëherë kur janë shkelur ndalesat e Allahut, kështu që është hakmarrë për Allahun.”*

Kjo është ajo për të cilën bota ka nevojë çdoherë! Kjo është ajo që po i mungon sot ummetit islam!

8. Qëndrimi ynë ndaj çifutëve dhe të krishterëve

Kur'ani ka sqaruar se qëndrimi i *ithtarëve të librit* nuk mund të jetë sikurse qëndrimi ynë ndaj tyre:

لَتَجِدَنَّ أَشَدَّ النَّاسِ عَدَاوَةً لِلَّذِينَ آمَنُوا الْيَهُودَ وَالَّذِينَ أَشْرَكُوا وَلَتَجِدَنَّ أَقْرَبَهُم مَّوَدَّةً لِلَّذِينَ آمَنُوا الَّذِينَ قَالُوا إِنَّا نَصَارَى ذَلِكَ بِأَنَّ مِنْهُمْ قِسِيَّيْنَ وَرُهْبَانًا وَأَنَّهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ

Gjithqysh ti do të vëresh se jehuditë dhe ata që i përshkruan Zotit shok (idhujtarët) janë njerëzit me armiqësi të fortë kundër besimtarëve (kundër muslimanëve). Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: "Ne jemi nesara-të krishterë". Këtë ngase prej tyre (të krishterëve) ka dijetarë (ulema) dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneçë." el-Maide, 82.

Dallimet që janë ndërmjet nesh nuk janë për shkak të dispozitave tona fetare, por për shkak të politikave diskriminuese, padrejtësisë dhe dhunës që muslimanët përjetojnë nga armiqtë e tyre. Armiqësia e çifutëve ndaj nesh nuk është për shkak të nivelit të besimit, por për shkak të urrejtjes dhe smirës që kanë ndaj nesh. Pavarësisht asaj që çifutët, të krishterët dhe ata që trasojnë rrugën e tyre bëjnë në Palestinë, Irak, Pakistan, Afganistan e vende të tjera islame, ne nuk kemi ndërruar asnjë qëndrim tonin juridik fetar (fikhist) ndaj tyre, sikur që nuk kemi

dispozita që i dallojnë të krishterët prej tyre. Por, kur i krishteri, çifuti dhe budisti kalojnë në armiqësi, atëherë qëndrimi ynë – pa bërë dallim ndërmjet tyre – është tjetër, dhe kjo si përmbushje e obligimit fetar për ruajtjen e jetës dhe fesë sonë.

Tensionet e krijuara ndërmjet nesh nuk kanë për themel dallimin tonë në besim, por në sjellje dhe qëndrime. Ne shpresojmë që Perëndimi, SHBA dhe Evropa, ta kuptojnë këtë dhe të punojnë në drejtim të përmirësimit të raporteve me muslimanët. Me këtë rast dhe në këtë konferencë urojmë përpjekjet e Presidentit Amerikan Barak Obama për përmirësimin e marrëdhënieve me muslimanët dhe për hapjen e një kapitulli të ri të administratës amerikane në politikat e saj të jashtme me muslimanët. Fjalimi i Presidentit Obama në Kajro dhe në vende të tjera nuk mund të shihet ndryshe veçse si një fillim i ri. Ummeti Islam është në pritje të realizimit të këtyre thirrjeve dhe ftesave në rrafshin praktik, e ditëve në vijim iu mbetet t'i vërtetojnë apo përgënjeshtrojnë këto thirrje e ftesa. Shpresojmë që këto ndryshime të prekin edhe bindjet dhe përpjekjet e tyre për shtrembërimin e imazhit islam dhe pejgamberit Muhammed, bindje që u manifestuan në Danimarkë, Holandë dhe SHBA, nga disa injorantë dhe rrugaçë. Është obligim që politika agresive dhe armiqësore e Perëndimit ndaj Islamit dhe muslimanëve të ndërrojë!

Po kështu edhe ne duhet të bëjmë dallime ndërmjet qëndrimeve politike dhe popullore, ngase shumica e problemeve tona me Perëndimin janë

për shkak të politikave të këqija të qeverive të tyre ndaj nesh e jo edhe të popujve, edhe pse këta të fundit kanë një rol që nuk mund të mohohet në shkaktimin e krizave dhe tendosjen e marrëdhënieve.

Propozim

Bashkësive Islame në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, dhe në të gjitha vendet e Ballkanit, gjithnjë duke u mbështetur në tekstet dhe rregullat fetare, iu bëj thirrje që të mos ua lejojnë studentëve të diplomuar ushtrimin e profesionit të imamit pa ndjekur një kurs të këtillë paraprakisht, në një interval kohor prej 2-3 muajsh. Kjo me qëllim që ata të akomodohen me ambientin larg të cilit kanë qëndruar për një kohë relativisht të gjatë, ndryshe problemet (si ai i akuzimit të njerëzve për kafir, mynafik, fasik, bidatxhi, i humbur etj) që do të mund të ndodhnin nga studentë të tillë, që nuk i janë nënshtruar kurseve të kësaj natyre, nuk do të duhej të na habisnin në të ardhmen.

Përfundimisht,

Duke pasur parasysh faktin se Pejgamberi (alejhi's selam) është dërguar mëshirë për botët, atëherë ajo me të cilën duhet të zbukurohet besimtari është mëshira, toleranca, butësia, bamirësia, humanizmi, mirëkuptimi dhe përpjekjet për t'i udhëzuar njerëzit në dritën e së vërtetës në të cilën jetojmë, mu ashtu siç thotë Allahu:

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ كَثِيرًا مِمَّا كُنْتُمْ تُخْفُونَ مِنَ الْكِتَابِ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ (15) يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

O ithtarë të librit, juve ju erdhi i dërguari Jonë që ju sqaron shumë nga ajo që fshihnit prej librit, e për shumë nuk ju jep sqarime. Juve ju erdhi nga All-llahu dritë dhe libër i qartë. 16. All-llahu e vë me atë (me Kur'anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e Tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë.” el-Maide, 15-16.

Lutja jonë e fundit është:

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!!!

El Medinetul Munewere, 2009